



KËRKESË PËR LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA

Për

1 AUTORITETI

Në bazë Nenit 5, 40 dhe 56 të Ligjit Nr.03/L-163, të shpallura më datën 27 Gusht 2010, si dhe nenit 34 të Ligjit me nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) ka autoritetin e përgjithshëm për të aprovuar Lejet e Veçanta.

2 INFORMATAT E KËRKESËS (të plotësohen nga Departamenti Ligjor të KPM)

Numri i Kërkesës të KPM-së

Data e paraqitjes së kërkesës (dd.mm.vvvv)

Koha e paraqitjes së kërkesës (ora)

Pranuar nga (Nënshkrimi) _____

3 INFORMATAT E PARAQITËSIT TË KËRKESËS

(të plotësohen nga paraqitësi i kërkesës)

Emri i biznesit

Përfaqësuar nga

Adresa e regjistruar zyrtarisht

Vendi i Aplikacionit

Zona Kadastrale – Komuna

Nr. Regjistrimit të biznesit

Nr. Licencës Shfrytëzimit

Numri i telefonit

Numri i telefonit mobil

Adresa elektronike

4 PARAQITJA E KËRKESËS

Dokumentacioni i kërkuar në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr.03/L-163, Neni 38

Personi që kërkon të ndërmarrë aktivitete të veçanta duhet t'i dorëzojë KPM-së një kërkesë të plotë për lëshimin e Lejes për kryerjen e aktivitetit të veçantë në fjalë. Kërkesa duhet të dorëzohet në formën e paraparë dhe me taksën e paguar administrative dhe bashkangjitur duhet të ketë:

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

- 4.1. Formularin e Kërkesës të kompletuar dhe të nënshkruar
- 4.2. Një kopje të Licencës së aplikuesit, me të cilën lidhet aktiviteti i veçantë;
- 4.3. Emrat dhe adresat e pronarëve të rëndësishëm dhe drejtorëve të aplikuesit, nëse ka të tillë
- 4.4. Certifikata e personit dhe secilit nga drejtuesit, udhëheqësit, drejtorët ose pronarët e rëndësishëm që paraqesin kërkesë-aplikojnë te sjellin nga gjykata kompetente që nuk është vërtetuar se ka kryer vepër penale në bazë të nenit 6 të këtij ligji
 - Ndërmarrja të sjell Certifikatën nga Gjykata me të cilin vërtetohet se ndërmarrja nuk ka kryer delikte ekonomike, nuk ka bankrotuar (falimentuar) në dy vitet e kaluara në bazë të nenit 6 të këtij ligji
 - Vërtetimin nga ATK-ja me të cilin dëshmohet se nuk është neglizhent në pagimin e tatimeve dhe detyrimeve në bazë të nenit 6 të këtij ligji
- 4.5. adresën zyrtare të regjistruar të aplikuesit në Kosovë (Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit)
- 4.6. një përshkrim të aftësive teknike, profesionale dhe menaxheriale të personelit që është kryesisht përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të veçanta në fjalë, duke përfshirë edhe kopje të CV-ve të tyre dhe nëse kërkohet me arsye nga KPMM, të gjitha diplomat, licencat dhe certifikatat përkatëse.
- 4.7. një ose më shumë harta që tregojnë:
 - 4.7.1. zonën për të cilën paraqitet kërkesa e definuar me koordinata
 - 4.7.2. lokacionin e çdo ndërtese, infrastrukture, aktiviteti bujqësor, apo të çdo përmirësimi domethënës artificial apo veçorie sipërfaqësore në atë zonë, ose që është brenda një kilometri distancë nga kufijtë e saj, dhe
 - 4.7.3. hyrja në këtë zonë e propozuar nga aplikuesi; dhe
 - 4.7.4. kufijtë e secilës Komunë kadastrale
- 4.8. të gjithë dokumentacionin kadastral të caktuar nga KPMM-ja:
 - 4.8.1. Fleta poseduese jo më e vjetër se 6 muaj
 - 4.8.2. Kopja e planit jo më e vjetër se 6 muaj
 - 4.8.3. Koordinatat e kufijve të licencës
- 4.9. pëlqimin mjedisor të lëshuar nga MMPH, pëlqimin Komunal dhe pëlqimin nga APK (nëse prona është në administrim të APK-së) dhe çfarëdo miratimi nga Autoritete tjera Publike të cilat kërkohen sipas ligjit të Kosovës dhe që specifikohen nga KPMM-ja.
- 4.10. Marrëveshje(t) mbi të drejtat sipërfaqësore, që kanë kohëzgjatje jo më të shkurtër se të Lejes së propozuar, mes aplikuesit dhe të gjitha palëve të treta që disponojnë mbi një të drejtë pronësore të regjistruar në mënyrë të ligjshme mbi sipërfaqen tokësore të cilën aplikuesi propozon të shfrytëzojë gjatë kryerjes së aktiviteteve të veçanta ose dëshmi që pala e tillë e tretë ka refuzuar ose në mënyrë tjetër nuk ka pranuar të lidhë një marrëveshje të tillë, edhe pse kjo e fundit ka qenë në baza të arsyeshme.
- 4.11. Lista e detajuar e numrave të regjistrimit të pajisjeve lëvizëse dhe të palëvizshme.

4.12. programi për aktivitetet e veçanta që propozohet të realizohet nga aplikuesi, dhe që përfshin:

4.12.1. një përshkrim të lokacionit, përmasave dhe kohëzgjatjes së programit të propozuar dhe të metodave, teknikave dhe pajisjeve që do të përdoren dhe

4.12.2. një program pune dhe një vlerësim të kostos

4.13. Projekti teknologjik i Impiantit

4.14. Projekti elektrik dhe protokollet shqyrtuese elektrike.

4.15. një program për rehabilitim të përgatitur në çdo rast nga ekspertë të kualifikuar dhe me përvojë

4.16. garancinë për përmbushjen e detyrimeve, në formën e përcaktuar nga KPMM, që garanton fonde të mjaftueshme për realizimin në kohën dhe sipas nevojës, të programit të rehabilitimit, garancia në fjalë duhet të jetë e barabartë ose më i madh se çmimi i përlllogaritur i programit në fjalë duke përfshirë edhe shpenzimet e paparashikuara dhe

4.17. dokumente të tjera që kërkohen me arsye nga KPMM-ja.

5 SHQYRTIMI I KËRKESËS

5.1. Brenda tre (3) muajve pas pranimit të kërkesës së plotë për Leje nga një aplikues i kualifikuar që plotëson të gjitha kërkesat që dalin nga neni 38, KPMM-ja ose do ta lëshojë Lejen në fjalë ose t'i dërgojë aplikuesit:

5.1.1. vendimin e KPMM-së për refuzimin e lejes,

5.1.2. një shpjegim me shkrim mbi arsyet për marrjen e këtij vendimi, dhe

5.1.3. një njoftim me shkrim me anë të të cilit njoftohet aplikuesi i kërkesës mbi të drejtën e tij për ankesë dhe shqyrtim gjyqësor të vendimit.

5.2. Në çdo kohë para skadimit të periudhës kohore prej tre (3) muajsh të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, KPMM në rrethana të jashtëzakonshme dhe në ushtrimin e diskrecionit të vet të arsyeshëm – mund të zgjat atë periudhë kohore edhe për një (1) muaj shtesë. Në rastin e tillë, KPMM menjëherë e njofton parashtruesin e kërkesës me shkrim për zgjatjen e tillë dhe arsyet për një gjë të tillë.

6 KRITERET E DHËNIES SË LEJES

6.1. KPMM-ja e lëshon Lejen përkatëse nëse kriteret në vijim janë plotësuar:

6.1.1. kushtet e paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji janë përmbushur

6.1.2. programi i aktiviteteve të veçanta është i bazuar në praktikat më të mira

6.1.3. aplikuesi:

6.1.3.1. ka burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit të aktiviteteve të veçanta, dhe

6.1.3.2. nuk është i përjashtuar në bazë të nenit 6 të këtij ligji,

6.1.4. kërkesa dhe aplikuesi janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji

6.1.5. secili autoritet publik nga i cili kërkohet lëshimi i një miratimi sipas ligjit të Kosovës ose e ka lëshuar miratimin në fjalë ose afati për lëshimin e tij ka skaduar dhe autoriteti publik nuk ka ndërmarrë veprimin e nevojshëm

6.1.6. aplikuesi i kërkesës është pajtuar me shkrim që t'i paguajë Qeverisë

6.1.6.1. çfarëdo kompensimi të shpronësimit i cili mund të kërkohet si rezultat i një procesi të shpronësimit të iniciuar nga KPMM sipas paragrafit 2 të këtij neni; dhe

6.1.6.2. çfarëdo shpenzime të arsyeshme të bëra nga Qeveria në lidhje me atë proces; dhe

6.1.7. të drejtat sipërfaqësore që nuk mbulohen nga marrëveshje mbi të drejtat sipërfaqësore janë përvetësuar nga aplikuesi i kërkesës ose janë shpronësuar ligjërisht dhe i janë dhënë aplikuesit të kërkesës në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

6.2. Nëse, sipas paragrafit 1 nën-paragrafit 1.8 të nenit 38 të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka siguruar dëshmi se një palë e tretë ka refuzuar ose ka dështuar të hynë në një Marrëveshje mbi të Drejtat Sipërfaqësore e cila mbulon të drejtat sipërfaqësore që në mënyrë të arsyeshme kërkohen nga parashtruesi i kërkesës për të ushtruar Programin e vet të Aktiviteteve të Veçanta, KPMM mund t'i parashtron një kërkesë – në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shpronësim – Qeverisë për shpronësimin e të drejtave të kërkuara sipërfaqësore dhe Qeveria do t'i shpronësojë këto të drejta. Pas përfundimit të procesit të shpronësimit, Qeveria i'a bart të drejtat sipërfaqësore parashtruesit të kërkesës për Leje pasi të ketë paguar shumat e përcaktuara në paragrafin 1 nën-paragrafi 1.6 të këtij neni.

7 DEKLARATA E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Parashtruesi i kërkesës siguron që dokumentacioni i dorëzuar të jetë i kompletuar dhe i vërtetë. Ai gjithashtu deklaron me nënshkrimin e tij se është informuar rreth kriterëve të kualifikimit të nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-163. Dorëzimi dhe/ose përdorimi i dokumenteve false dhe deklaratat çorientuese paraqet shkelje të Kodit Penal të Kosovës dhe do të rezultojë në përndjekje penale nga autoritetet kompetente.

Nënshkrimi i autorizuar:

Parashtruesi i kërkesës

Datë:
